



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**A nr. 766/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtaret Hasan Shala kryesues, Ferit Osmani, dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Visar Sadiku, kandidat për anëtar të kuvendit komunalë në Vushtrri nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Lidhja Demokratike e Dardanisë (LDD), paraqitur kundër publikimit të raportit preliminar të shpallur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mungesës së votave për zgjedhjet lokale të datës 03 Nëntorit 2013, në seancën e panelit të mbajtur me 11.11.2013, mori këtë:

**V E N D I M**

**HIDHET** si e palejueshme ankesa e Visar Sadiku, kandidat për anëtar të kuvendit komunalë në Fushe Kosovë nga subjekti politik politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Lidhja Demokratike e Dardanisë (LDD).

**Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 08.11.2013, nga Visar Sadiku, kandidat për anëtar të kuvendit komunalë në Vushtrri nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Lidhja Demokratike e Dardanisë (LDD), në të cilën pretendohet që të verifikohet procesi i numrimit në qendrën e votimit 2711B/01R, 02R 03R, 04R, ku në të gjitha vendvotimet sepse gjatë numrimit nga ana e komisionerëve më është bërë tjetërsimi i votës duke ju regjistruar kandidatëve të tjerë në proces si votë e tyre.

PZAP-i, shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

**Ankesa është e palejuar**

PZAP-i, konstatoi se ankesa është e palejuar ngase rezultatit preliminarë i shpallur nga KQZ-ja nuk është përfundimtar dhe mund të ndryshoj në çdo moment dhe po ashtu


ankesa në fjalë për rezultat preliminar në vendvotim është dashtë të parashtrohet në PZAP nga anëtarët e komisionit të vendvotimit sipas nenit 102.1 të LZP-së parasheh se *“Çdo anëtarë o komisionit të Vendvotimit që ka vërejtje në rezultatet e shënuara në një vendvotim mund të regjistroj mospajtimin tij në librin e votimeve te vendvotimit dhe mund të dërgoj një vërejtje te Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në përputhje me këtë ligj”*. Në rastin konkret ankesa është parashtruar nga kandidati për anëtarë të kuvendit komunal që nuk është person i autorizuar sipas ligjit të parashtroi ankesë sipas dispozitës së lartcekur.

Bazuar në arsyet e sipërshënuar dhe në kuptim te nenit 118.1 te LZP-së i cili parasheh se *“PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin standardet”* dhe nenit 4.2 te Rregullave dhe Procedurave te PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: *“PZAP-i, mund ti hidh poshtë (si të palejuar, të parregullta apo të pa afatshme) ankesat, të cilat nuk i plotësojnë kriteret e parapara në nenin 3 të këtyre rregullave dhe procedurave, po ashtu PZAP refuzon ankesat te cilat janë të pabazuara, apo të cilat janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore”*, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

A nr. 766/2013 më datën 11.11.2013

**Kryesuesi i Panelit  
Hasan Shala**



**Këshillë juridike:** *PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*